

# SJELLJA VOTUESE E TË RINJVE NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE 25 PRILL 2021



Ky botim u përgatit përmes projektit "Zgjedhje Gjithëpërfshirëse" të financuar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet dhe përmbajtja e tij janë të autorit.

QENDRESA  
QYTETARE



WFD



Funded by  
UK Government

PRILL/2021



# 1. Sjellja votuese e të rinjve. Qëllimi dhe metodologjia e studimit

Qëndresa Qytetare u angazhua në një proces monitorimi të sjelljes votuese të të rinjve të grupmoshës 18 – 29 vjeç në zgjedhjet parlamentare të 25 prillit. Synimi i monitorimit ditën e zgjedhjeve ishte mbledhja e opinioneve të votuesve të rinj mbi praktikën, standardin dhe pritjet nga votimi. Duke marrë opinione nga të rinj që i përkasin gjinive, kategorive të ndryshme sociale dhe votuesve për here të parë, ne u përpoqëm të gjenim perceptimin mbi votën rinore në 5 qarqe të vendit, prirjet e saj lidhur me alternativat politike, si dhe raportin e saj me legjislacionin e ri zgjedhor.

Qëllimi i këtij anketimi është fokusimi tek rëndësia e votës, tek detyra qytetare e zgjedhjes, tek ndjesia e tyre për votën dhe pritshmëritë ndaj saj, tek çështjet preferenciale të votimit dhe sidomos edhe tek testimi i njohurive, risive e problematikave lidhur me praktikën e reja zgjedhore që u mundësuan me ndryshimet në Kodin Zgjedhor dhe me ndryshimet Kushtetuese.

## 01 | TË DHËNA DEMOGRAFIKE




Totali i anketave: **300**

Grupmosha: **18-29 vjeç**


Shpërndarë në :  
**TIRANË, ELBASAN  
KUKËS, DURRËS, FIER**

Gjinia: **49%** **51%**

A jeni votues për  
herë të parë?



A bëni pjesë në ndonjë parti politike  
ose forum rinor të partisë politike?



## Metodologjia

Të rinjtë u pyetën pasi dolën nga qendra e votimit, me një set pyetjesh duke respektuar parimin: pyetet çdo i tretë votues nga të rinjtë që votojnë, duke ruajtur anonimat dhe duke evituar pyetjet për grupe të rinjsh apo për të rinj të shoqëruar nga familja. U realizuan në total 300 pyetësorë, përkatësisht nga 60 votues të rinj për secilin qark. Konkretisht, anketimi u shtri në qarqet: Tiranë, Elbasan, Kukës, Durrës dhe Fier, në 15 qendra votimi.

Mosha e të anketuarve ishte 18 – 29 vjeç, nga të cilët 51% e të pyeturve ishin vajza. Rreth 73% e të pyeturve ishin me arsim unviersitar ose pasuniversitar, ndërsa 27% e tyre me arsim të mesëm ose fillor. Në total 35% e të anketuarve ishin votues për herë të parë, ndërsa 65% e tyre ishin votues për herë të dytë ose më shumë se dy herë. 73% e të rinjve të pyetur nuk bënë pjesë në forcat politikë, ndërsa 24% e tyre ishin pjesë e partive politike garuese në zgjedhjet e 25 Prillit. 3% nuk janë përgjigjur pyetjes. Pyetësi u hartua nga ekspertë të fushës dhe u testua paraprakisht nga një grup të rinjsh përpara ditës së votimit.

## 2. Orientimi i votës

Nisur nga problematikat ndër vite, si skepticizmi i të rinjve ndaj rëndësisë së votës, ofrimi i parave në këmbim të votës apo votimi familjar, të rinjtë u pyetën për besimin dhe orientimin e votës. Rreth 76.4% e të rinjve besojnë se vota e tyre do të ishte përcaktuese në rezultatin e zgjedhjeve, ndërsa 13.8% besojnë se ajo nuk ndikon në rezultat. Vetëm 9.8% e të rinjve u shprehën se nuk e dinë nëse vota e tyre do të ndikojë në rezultatin e zgjedhjeve.

Një nga gjetjet më interesante ishte ajo, sipas të cilës, 60.5% e të rinjve deklaruan se kanë votuar si familja e tyre, 16.4% kanë votuar ndryshe nga familja dhe 23.1% kanë refuzuar të përgjigjen. Ndikimi i familjes është i dyanshëm: nga totali, 40.5% e të rinjve të pyetur janë shprehur se familja e tyre ka votuar për kandidatin që ata i kanë këshilluar.


Lidhur me integritetin e votimit, 15.4% e votuesve të rinj pohojnë se u janë ofruar para ose të mira materiale gjatë fushatës zgjedhore në këmbim të votës, ndërsa 83.6% e tyre mohojnë të kenë pasur oferta të tilla. Vetëm 1% e tyre refuzuan të përgjigjen.

Shpesh herë të rinjtë shqiptarë shprehen skeptikë për bashkëmoshatarët e tyre në politikë. Në këtë linjë ishin 62.1% e të anketuarve, të cilët u shprehën se kandidatët e rinj në lista nuk patën ndikim për t'i çuar ata në kutitë e votimit. Nga ana tjetër, 33.8% e tyre pohojnë se janë ndikuar nga prezenca e kandidatëve të rinj në lista për të shkuar për të votuar, ndërsa 4.1% kanë refuzuar të përgjigjen.


## 02 | ORIENTIMI I VOTËS

Ky infografik u përgatit përmes projektit "Zgjedhjet e Mirënjohura" të financuar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Përbërjet dhe përmbajtja e tij janë të azhuruara.


Mendoni se vota e juaj do të ndikojë në rezultatin e zgjedhjeve?



Votimi juaj, ishte vendimmarrje e njëjtë apo e ndryshme nga ajo e familjes suaj?



A ka votuar familja juaj për kandidatin që ju i keni këshilluar?



A pati ndikim në votën tuaj fakti se në listën e partisë që votuat kishte kandidatë në moshë të re?



A ju ka ndodhur që gjatë fushatës elektorale dikush t'ju ofrojë para apo diçka tjetër në shkëmbim të votës?



### 3. Besimi tek partia fituese

Pritshmëritë e të rinjve për korrelacionin midis votës së tyre dhe partisë fituese të zgjedhjeve rezultojnë të jenë të larta. 85% e të rinjve votues në zgjedhjet e 25 prillit prisnin që partia që ata votuan të fitonte zgjedhjet, ndaj 15% që nuk kishin pritshmëri të tilla. Ky është një tregues që vetëm një pjesë e vogël e të rinjve mund të kenë zgjedhur për të votuar për parti të cilat mund të mos jenë perceptuar fituese të zgjedhjeve, ndryshe nga dy forcat e mëdha politike në vend.



Premtimet zgjedhore të bazuara në programet e shkruara, në tërësi munguan. Ato u zvendësuan me video mesazhe, fjalime dhe deklarime kryesisht në mediat sociale nga liderët politikë. Pavarësisht kësaj, 75.9% e të rinjve shprehen se janë njohur më programin e partisë përpara se ta votojnë, ndërsa 20.5% e tyre nuk janë njohur me programin. 3% nuk janë përgjigjur ndaj kësaj pyetje.


Pavarësisht se premtimet kryesore të forcave politike në fushatën zgjedhore lidheshin me integrimin dhe progresin e vendit, vetëm një e treta e të rinjve të pyetur besojnë se partia fituese nuk do arrijë të mbajë premtimin për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Rreth 41% e tyre rendisin si premtime jo realiste dhe për pasojë edhe të pamundura për t'u mbajtur nga partia fituese ato premtime që lidhen me arsimin (8.7%), punësimin (15.4%), shëndetësinë (5.1%) dhe ekonominë (11.8%). Pjesa tjetër, prej 25.6% e të pyeturve janë të bindur se partitë nuk do të mbajnë një premtim tjetër, përtej të sipërcituarave, të cilin e kanë bërë gjatë fushatës në nivel kombëtar apo zona të caktuara zgjedhore.

Nisur nga kontestimet e shumta të zgjedhjeve në të kaluarën, ne arritëm të marrim një perceptim të të rinjve lidhur me këtë problematikë. Vetëm 41.5% e të pyeturve shprehen se partia humbëse do të njohë rezultatin e zgjedhjeve, 33.8% pohojnë të kundërtën, ndërsa 24.6% e të rinjve nuk ishin në gjendje për një opinion të qartë rreth kësaj pyetje.

## 03 | BESIMI TEK PARTIA FITUESE



A keni pasur mundësi të  
njiheni me programin elektorale  
të partisë dhe kandidatit  
që votuat?



Premtimi mbi cilën  
çështje ju ka bindur  
të votoni partinë  
dhe kandidatit e  
përzgjedhur?



Premtimin mbi  
cilën çështje  
besoni se partia  
fituese nuk do të  
arrijë ta mbajë?



A prisni që partia/partitë  
humbëse të njohin  
rezultatit e zgjedhjeve?

Po 41.6%

Jo 33.8%

24.6% Pa Përgjigje

## 4. Opinioni i të rinjve mbi risitë elektorale të 25 Prillit

Zgjedhjet e 25 prillit u shoqëruan nga disa risi në procesin e votimit, numërimit dhe votës preferenciale për të cilat pati konsensus politik mes palëve politike nga marrëveshja e 5 qershorit 2020. Pas daljes së rezultateve zyrtare u njoftua se kishte mbi 83 000 vota të pavlefshme, rreth 50 000 më shumë se në vitin 2017. Ky fenomen u shpjegua kryesisht me vështirësitë e hasura gjatë plotësimit të fletës së votimit nga zgjedhësit.


Në lidhje me njohuritë mbi sistemin e votimit 74.4% e të rinjve që votuan e kanë vlerësuar formën e re të votimit si të lehtë për ta plotësuar, ndërsa 20% e tyre e kanë konsideruar si të vështirë. Pjesa tjetër prej 5.6% e të pyeturve nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje. Gjithashtu, 87% e të rinjve e vlerësojnë pozitivisht sistemin elektorale me lista të hapura, ndërsa vetëm 2.5% e tyre mendojnë që është një sistem i keq. Në total, 10.5% e të rinjve nuk kanë një vlerësim mbi këtë çështje.

Pritshmëritë e të rinjve për kandidatët preferencialë në listat për deputetë janë gjithashtu të larta. Bazuar në të dhëna, 67.2% e votuesve të rinj presin që vota preferenciale për kandidatët do të sjellë ndryshime në listën finale fituese të partisë, ndërsa 12.3% e të pyeturve nuk presin që lista të ndryshojë nga vota preferenciale. Pjesa tjetër prej 20.5% e të rinjve të pyetur nuk kanë një opinion mbi këtë çështje.

Së fundi, 70% e votuesve të rinj kanë besim se vota e tyre do të numërohet 100% në rregull dhe pa u cënuar rezultati, 15.5% e tyre nuk besojnë tek një proces transparent numërimi, ndërsa 14.5% e tyre nuk kanë një opinion mbi këtë çështje.

### 04 | OPINIONI I TË RINJVE MBI RISITË ELEKTORALE TË 25 PRILLIT


Cili është vlerësimi juaj për formën e re të votimit ?



Premtimi mbi cilën çështje ju ka bindur të votoni partinë dhe kandidatën e përzgjedhur?



A prisni që vota për kandidatët do të sjellë ndryshime në listën finale fituese të partisë?



A keni besim se vota juaj do të numërohet 100% në rregull, pa u cënuar rezultati?



## 5. Gjetjet kryesore



- **Ndikimi familjar** në përcaktimin e preferencës politike mbetet shumë i lartë: **60.5% e të rinjve kanë votuar si familja e tyre.**



- Shitblerja e votes mbetet shqetësim: **15.4% e votuesve të rinj pohojnë se u janë ofruar para ose të mira materiale gjatë fushatës zgjedhore në këmbim të votës.**



- Prurjet e reja në politikë kanë pak ndikim tek vota e të rinjve: **62.1% e të rinjve shprehën se kandidatët e rinj nuk patën ndikim për t'i çuar ata në kutitë e votimit, ndërsa 33.8% e tyre pohojnë se janë ndikuar nga prezenca e kandidatëve të rinj në lista për të shkuar në votime.**



- Mosbesimi tek sjellja konstruktive e politikës: një në tre të rinj **mendojnë se partia humbëse nuk do të njohë rezultatin e zgjedhjeve.**



- Mosbesimi tek premtimet elektorale: **66.7% e të rinjve besojnë se partitë nuk do të mbajnë premtimet për arsimin, punësimin, ekonominë apo shëndetësinë, si dhe 33.3% premtimin për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.**



- Rinia e mbështet sistemin e ri zgjedhor: **87% e vlerësojnë pozitivisht sistemin elektorale me lista të hapura, 74.4% e votuesve të rinj e kanë vlerësuar formën e re të votimit si të lehtë për ta plotësuar,**



- Besimi tek vota parapëlqyese: **67.2% e votuesve të rinj presin që vota preferenciale për kandidatët do të sjellë ndryshime në listën finale fituese të partisë.**



- Besimi tek siguria e votës dhe votimi: **70% e votuesve të rinj kanë besim se vota e tyre do të numërohet 100% në rregull dhe pa u cënuar rezultati, vetëm 15.5% e tyre nuk besojnë tek një proces transparent numërimi.**

## Rekomandime

- **Votuesit e rinj kanë nevojë për më shumë ndërgjegjësime për rëndësinë e votes personale, pa ndikim familjar.**
- **Partitë duhet të përgatisin programe politike të plota, më realiste, më transparente dhe përfaqësuese edhe të interesave të të rinjve për të krijuar besim dhe pritshmëri tek premtimet elektorale.**
- **Partitë politike duhet të krijojnë një mjedis më të hapur dhe konkures për të rinjtë brenda forcës së tyre politike në mënyrë që të risin besimin e votuesve të rinj si dhe të harmonizojnë prurjet e reja me pritshmëritë rinore ndaj tyre.**
- **Organet e hetimit dhe parandalimit të korrupsionit duhet të mundësojnë dënimin e rasteve të shitblerjes, fotografimit dhe ndikimit të votës për të krijuar kulturën e ndëshkueshmërisë së krimeve zgjedhore.**
- **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, institucionet me ndikim, media dhe aktorët e shoqërisë civile, në periudhën midis zgjedhjeve duhet të nxisin informimin dhe sensibilizimin e votuesve të rinj për sistemin zgjedhor, sistemin përfaqësues, procedurat e votimit dhe rëndësinë e tij.**